



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 36-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 27. 12. 2016 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi, anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Ukë Kryeziu, anëtar
13. Merita Zeqiri-Hajrizi anëtar
14. Hajrije Salihu, anëtar
15. Blerim Gashi, anëtar
16. Adelina Krasniqi, anëtar
17. Florent Hoxha, anëtar
18. Petrit Kelmendi anëtar
19. Lulzim Rustemi, anëtar
20. Nazmi Krasniqi anëtar
21. Enver Kozhani, anëtar
22. Feriz Hasani, anëtar
23. Ali Stublla, anëtar
24. Valbona Shillova, anëtar
25. Burbuqe Ilazi, anëtar
26. Vlora Buja, anëtar
27. Arben Bahtiri, anëtar
28. Edita Gashi, anëtar
29. Ramiz Qeriqi, anëtar
30. Zoran Çirkovic anëtar
31. Xhavid Maholli anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës
3. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës
4. Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF-së
5. Fauz Xhemajli, Drejtor i administratës
6. Ilir Tasholli, Drejtor i DPU-se
7. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
8. Feti Krasniqi, Drejtor i DBPZHR
9. Imer Rustemi, Drejtor i DI
10. Avni Olluri, Drejtor i GJK
11. Haset Sahiti, Drejtor i DSHP
12. Burim Rustemi, Shef i kabinetit
13. Bukurie Zejnullahu-Jashari, zyrtare për informim
14. Kimete Jashanica, OSBE
15. Përfaqësues të OJQ "POLIS"
16. Përfaqësuesit e mediave
17. Bestar Ibrahim, Operator i teknologjis informative
18. Bajram Zaskoku, përkthyes shqip-serbisht
19. Haki Avdiu , operator i zërimit

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**

Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 24 anëtarë nga gjithsej 31 dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe të njëjtin e lexoi në vazhdim duke shtuar se në pikën e pestë kemi ndryshim dhe në vend të informatës duhet të thuhet raport.

Pastaj vuri në votim rendin e ditës së propozuar së bashku me propozimin për ndryshim në pikën e pestë dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me të gjitha votat, për punën e kësaj mbledhje, aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 35-të të Kuvendit
2. Propozim Rregullorë për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.
3. Propozim Vendim për emërtimin e parkut të qytetit me emrin e Heroit të Kosovës Ismet Asllani.
4. Propozim Vendim për miratimin e planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme.
5. Raport nga DKRS për aktivitetet sportive.

Pasta tha se para se të kalohet në punë sipas rendit të ditës së aprovuar, Kryesuesja propozoj që të kalojmë në pyetje dhe përgjegjje të anëtarëve të Kuvendit dhe pyes se a ka dikush ndonjë pyetje?

Florent Hoxha, unë dua t'i ngriti disa shqetësime të PDK-së dhe qytetarëve ku në disa shkolla është ngjitur një fletushkë ku Kryetari i Komunës është shpallë Kryetar kampion dhe në këtë fletushkë është llogu e Komunës dhe e Republikës dhe askund nuk shkruhet emëri i Komunës dhe Republikës së Kosovës, andaj nëse këto fletushka i ka vendosur Drejtoria, kërkoj nga Drejtori që mos të bastradhohet emri i Republikës dhe i Komunës.

Si qështje tjetër është që ditën e fundit të përfundimit të mësimit në disa shkolla ka thyerje të bankave dhe karrigave që dihen publikisht dhe janë të inqizume se në cilën shkollë ka ndodh kjo dhe cilët nxënës i kanë bërë këto, ndërsa denoncimi i Kryetarit është se kjo nuk ka ndodh në Komunën e Lipjanit. Në vazhdim pyeti se kupëzat që janë ndërru gjatë mbjelljes së drunjëve dekorativ ku kanë mbetë ato kupëza që janë hjekë se dihet se ato janë asete të Komunës.

Shqetësim tjetër është ku në dy puseta janë vjedhur kapakët e tani është rrezik që në këto puseta të bijnë fëmijët.

Shqetësim tjetër është hudhja e mbeturinave brenda zonës së qytetit dhe është mirë që në ato vende të vëhet tabela me mbishkrimin ndalohet hudhja e mbeturinave.

Te tregu i gjelbërt është kriju një deponi e mbeturinave dhe është mirë që kjo sa më parë të hiqet.

Valbona Shillova, paraqiti reagimin e sajë lidhur me qështjen e mangësive në lapidarin e martirëve në fshatin Kraishtë e që në vazhdim lexoi materialin e përgatitur me shkrim lidhur me këtë qështje i cili material është pjesë përbërse e procesverbalit.

Blerim Gashi, unë do të lidhem me diskutimin e Florentit lidhur me rastin e shkollës tonë ku tha se janë thyer karriga dhe tavolina por ju them se në shkollë ditëve të fundit na i kemi shtuar masat e sigurisë se e kemi ditë se është fundi i vitit dhe askush në shkollë nuk ka vërejtje dhe nuk e dijmë këtë që e tha Florenti dhe konsideroj se këtë qështje duhet t'ua lënë organeve përgjegjëse.

Si pyetje e dytë ishte pse ka mungesë të madhe të barnave emergjente në QKMF dhe a ka mundësi qeveria lokale të intervenojë për blerjen e këtyre barnave.

Naim Jahiri, pyeti se a ka mundësi Komuna të ndaj mirënjohje për Ilmi Ollurin i cili në SHBA ka bërë një prezantim dhe ndërhyrje me përmasa ndërkombëtare e që në SHBA i kanë dhënë hapsirë të veçantë këtij rasti.

Në fund në emër të LDK-së dashta ta falenderoj Kryetarin për punën që ka bërë në infrastrukturën e Komunës së Lipjanit që asnjëherë më parë nuk është bërë kjo punë.

Lulzim Rustemi, unë edhe në mbledhjen e kaluar e kam bërë pyetjen lidhur me punimet që po zhvillohen në sheshin "Adem Jashari" dhe se projekti ka devijuar nga projekti i mëparshëm por sot, po e ngris qështjen e rrjedhjes të ujit të pishëm i cili është lidhur me një gyp dhe derdhet pa ndërprerë 24 orë në pusetën e kanalizimit dhe kjo është që disa ditë andaj kërkoj që sa më parë të sanohet kjo gjendje.

Xhavit Maholli, në Gadime të Ulët janë shtruar dy rrugë mirëpo afër varrezave kanë mbetur pa u shtrur 30-40 metra dhe pyes pse nuk janë shtrur.

Te shkolla "Ernest Koliqi" në mesin e oborrit të shkollës janë 2-3 shtylla të cilat pengojnë hapsirën e shkollës dhe nxënësit dhe pyes se a ka mundësi që të largohen këto shtylla.

Në shtëpinë e shëndetit në Lipjan pyes se orari i pushimit a është një orë apo gjysmë ore meqë personalisht unë një ditë kam pritë mbi një orë andaj pyes se a ka mundësi që gjatë këtij pushimi të zëvendësohen mjekët në mënyrë që mos të presin të sëmurët.

Ramiz Qeriqi, unë kam parashtrur disa kërkesa por si duket kërkesat e mia kanë shkuar në vesh të shurdhët dhe asnjëherë nuk mu ka kthyer përgjigje, si shembull, për shkollën në Grackë të Vjetër pranimit i rojës në shkollën e mesme, pat filluar marrjen e pronave atyre që u kemi dhënë më herët e që nuk ju kanë përmbajtur marrëveshjeve por tani kjo qështje ka stagnu. Gjithashtu unë qdo herë kam ngritur zërin për punët që janë punuar keq si shembull te rruga që është shtrur te na asfalti është shtrur natën dhe ka vende që është vetëm 2 cm dhe tani ky asfalt është qarë dhe ka dalë balta.

Sa i përket varrezave që janë rregullu në Kraishtë ka disa mangësi aty por për këtë do të flas në mbledhjen e radhës. Në fund përmendi mos zhvillimin e lojës të klubit futbollistik "Ulpiana" në Lipjan e që për këtë fajsoj kryesinë e klubit e cila nuk ka lejuar të luhet kjo lojë.

Daut Azemi, e dijmë se ditëve të fundit në fshatin Babush ka pasur protesta për shkak të mos përmbushjes të disa kushteve të premtuara nga "Bektel Enka" dhe falenderoj Kryetarin që na ka përkrahë dhe me përkrahjen e tij janë realizu shumica e kërkesave tona. Në vazhdim kërkoj që prej Kredit Bankës e deri kthesa e parë që shkon për Janjevë të lirohet trotuari nga parkimi i automjeteve. Në fund uroj Kryetarin për shpalljen Kryetar Kampion.

Hajrije Salihu, kërkoj që të shkolla profesionale "Adem Gllavica" të sigurohet auto parkim për punëtorët e shkollës.

Ali Stublla, pyeti pse në QKMF nuk ka mjaft mjekë sidomos në emërgjencë dhe a është në pyetje qështja financiare apo pse meqë në një rast urgjent mjeku është marrë vetëm me këtë rast disa kohë kurse pacientët pritshin se nuk kishte tjetër mjek.

Pastaj tha se sipas informatave që kam me buxhetin e Republikës së Kosovës është parapa asfaltimi i rrugës Topliqan-Vojnovcë që sipas mendimit tim më mirë ka qenë të parashihet asfaltimi i rrugës Topliqan-Kojuskë ku gjatë luftës kjo rrugë ka pasur frekuentim të madh dhe është rrugë historike.

Xhevat Olluri, është për t'u lavdru vendosja e pengesës në rrugë të shkolla e mesme mirëpo është mirë që të kjo pengesë të vëhen vijat vertikale në mënyrë që të vëhet më larg pengesa meqë shumë vozitës nuk po e vërejnë dhe hyjnë me shpejtësi aty dhe mund të dëmtojnë veturat.

Qështje tjetër është se hekurudha Fushë Kosovë-Ferizaj do të modernizohet dhe është mirë që të stacioni i trenit të parashihet nënkalimi meqë aty është rrezik permanent për kalimtarë. Gjithashtu është mirë që Komuna të mendon edhe për projekte të tifit në mënyrë që të konkurojmë me ndonjë projekt që sigurisht mund të përfitojmë.

Feriz Hasani, para 2-3 seancave e kam ngritur një shqetësim lidhur me vendosjen e murit në parcelën ku po ndërtohet fabrika e kërpurdhave dhe ky muri është vendosur në rrjedhën e prockës dhe është thënë se do të vëhen gypat por tani janë vu vetëm 20 m gypa dhe nga uji është dëmtuar rruga.

Imri Ahmeti, unë i kam marrë seriozisht pyetjet e juaja dhe do të mundohem të ju përgjigjem si vijon:

Qështja e videos në portalet e Lipjanit nuk i dihet autorësia se e kujt është dhe nga ka ardhur kjo por zyrtarët do të adresojnë këtë qështje.

Për varrezat në Kraishtë dhe Ribar ka qenë iniciativë e imja dhe e kam realizu këtë projekt dhe unë nuk e kam vendosur asnjë emër por emrat i ka vendosur Këshilli i fshatit Kraishtë të cilët edhe janë falenderu për këtë projekt.

Ne së shpejti do ta vendosim edhe lapidarin e Ismet Asllanit e që edhe aty ndoshta ka me pasur vërejtje.

Në Gadime janë shtruar rrugët por dihet se projektet janë 2 vjeqare dhe unë nuk e di që se ku kanë mbetur pa u shtrur 30-40 m.

U përmend marrja e pronave të cilat janë dhënë në shfrytëzim na kemi fillue dhe do të vazhdojmë me këto procedura.

Për rrugën Vojnovcë – Topliqan ky është projekt i përbashkët me Komunën e Shtimes.

Për pengesat në rrugë të shkolla që përmendi Xhevati unë konsideroj se është bërë në mënyrë profesionale.

Për pyetjen e Hajrijes për sigurimin e auto parkimit të shkolla “Adem Gllavica” unë mendoj se parkimi i automjeteve duhet të bëhet brenda në oborr të shkollës.

Avdullah Fazliu, drejtor i drejtoratit për shëndetësi tha se furnizimi me barna esenciale nuk është problem vetëm në Komunën tonë por në të gjitha komunat dhe në herën e fundit me barna esenciale jemi furnizur me 21 tetor e nga niveli qëndrorë qdo herë na kanë thënë se jemi duke përgatitur listat.

Sa i përket falenderimit për Ilmi Ollurin ai është punëtorë i QKMF-së dhe ata duhet ta bëjnë këtë.

Sa i përket orarit të pushimit të mjekëve pushimi është gjysëm ore dhe në qdo derë shkruan emri dhe mbiemri dhe orari i punës.

Në emergjencë janë 2 mjek e gjithashtu do të caktohet edhe orari i barnatoreve për 24 orë.

Florent Hoxha, Kërkoj që vendimi i orarit të punës dhe i kujdestarive të barnatoreve të publikohet.

Ukë Kryeziu, orari i kujdestarisë qdo herë vëhet në derë.

Sa i përket furnizimit me barna unë jam përgjegjës për furnizim dhe lista për barna esenciale nuk i përfshin të gjitha barnat dhe vetëm 42% jemi të furnizuar me barna esenciale. Në vazhdim foli lidhur me aktivitetet që kryhen nga sektori që udhëheq ai.

Heset Sahiti, të pushtat që u përmendën se janë vjedhë neve zakonisht na informojnë qytetarët gjithashtu edhe policia dhe qdo herë intervenojmë në këto raste.

Të kupëzat që janë hjekë ato kanë qenë të dëmtuara dhe i kemi hedhë në meturina.

Sa ju përket projekteve të cilat kanë qenë të kontraktuara ato janë menaxhu nga menaxherët.

Meqë pyetje tjera nuk pati u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 35-të e Kuvendit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 35-të të Kuvendit?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë përkatësisht nuk pati vërejtje apo plotësime, Kryesuesja të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, asnjë kundër

Aprovoi

Ekstraktin nga procesverbali e mbledhjes së 35-të të Kuvendit pa vërejtje

Shtesë: Ekstrakti.

II

Propozim Rregullore për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Fauz Xhemajli, Drejtor i DA, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit nga propozim Rregullorja duke shtuar se në këtë Rregullore kemi disa ndryshime si vijon:

a). Te neni 4 pas paragrafit 4 shtohet paragrafi i ri 5 i cili thekson:

5."Komuna bashk me hartimin dhe miratimin e buxhetit do të hartojë dhe miratojë edhe planin e ndarjes së subvencioneve sipas kategorive të propozuara në këtë Rregullore"

b). Te neni 6 pas paragrafit 4 shtohet paragraf i ri, paragrafi 5 i cili thekson:

5. "Në rast se përfituesi i subvencionit të pranuar nga Komuna është person juridik dhe nuk arrinë të realizoj qëllimin e subvencionit konform marrëveshjes për subvencionim, përfituesi do të obligohet të e kthej shumën e pranuar të mjeteve në tërësi, ose pjesën e mbetur të pa realizuar konform marrëveshjes".

c) Te neni 15 ndryshohet paragrafi 3 dhe formulohet si vijon:

3. "Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues i bursës nëse brenda vitit të njëjtë fiskal ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga Univerziteti Publik ku studion, kolegjet private, qeveria, agjencitë e pavarur qeveritare, kompani publike ose ndonjë donatorë tjetër për fushën e njëjtë.

d) Te neni 16 te nën paragrafi 1.5 te fjala ndërmarrje publike shtohet fjala lokale, ndërsa nën paragrafi 1.2 aksesore fshihet dhe renditen paragrafet sipas radhës.

e) Te neni 17 pas paragrafit 1.1 shtohet paragraf i ri 1.2 i cili thekson:

1.2 "përparsi do t'u epet grave që kërkojnë subvencion e të cilat kanë pronë të regjistruar në emër të tyre ose pronë të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve".

Nënë paragrafet e nenit 17 ndryshojnë renditjen dhe shkruhen sipas radhës.

f). Duke bazuar në rekomandin e OJQ"POLIS' të dhënë gjatë debatit publik është formuluar një nen i veçant vetëm për OJQ-të dhe sindikatat që propozojnë që të bëhet një ndarje në nenet e veqanta të OJQ-ve nga sindikatat si vijon:

Neni 23

Subvencionet për Organizatat joqeveritare

Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve për OJQ-të aktive për realizimin e aktiviteteve dhe projekteve të tyre të ndryshme në interes të Komunës. Ndarja e subvencioneve do të bëhet nëpërmjet thirrjes publike në përjashtim të rasteve specifike me kërkesë të arsyeshme sipas Vendimit të arsyetuar të Kryetarit të Komunës.

Neni 24

Dokumentacioni i kërkuar për Organizatat joqeveritare

1. Organizat joqeveritare të cilët parashtrojnë kërkesë për mbështetje financiare duhet të prezantojnë dokumentacionin si vijon:

1.1. Çertifikatën e regjistrimit të personit juridik,

1.2. Çertifikatën e numrit fiskal,

1.3. Numrin e xhirollogarisë bankare të personit juridik,

1.4. Fotokopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar për tërheqjen e mjeteve,

1.5. Autorizimi,

- 1.6. Projekti,
- 1.7. Plani financiar,
- 1.8. Varësisht nga lloji i kërkesës mund të kërkohej edhe dëshmi tjera plotësuese.

Neni 25 Subencionet për sindikatat ndryshme

Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve për Sindikatat e ndryshme që veprojnë në Komunë për realizimin e aktiviteteve dhe projekteve të tyre të ndryshme që janë me interes për Komunën. Ndarja e subvencioneve do të bëhet sipas kërkesave të tyre të arsyeshme me Vendim të arsyetuar të Kryetarit të Komunës.

Neni 26 Dokumentacioni i kërkuar për sindikatat e ndryshme

1. Sindikatat e ndryshme të cilat parashtrojnë kërkesë për mbështetje financiare duhet të prezantojnë dokumentacionin si vijon:

- 1.1. Aktvendimin e regjistrimit,
- 1.2. Çertifikatën e numrit fiskal,
- 1.3. Kopjen e kartelës së xhirollogarisë bankare të sindikatës,
- 1.4. Fotokopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar për tërheqjen e mjeteve,
- 1.5. Autorizimi,
- 1.6. Projekti,
- 1.7. Plani financiar,
- 1.8. Varësisht nga lloji i kërkesës mund të kërkohej edhe dëshmi tjera plotësuese

g). Pas këtij ndryshimi ndryshojnë numrat e neneve në vijim

Vlora Limani-Hajnuni, propozimet për ndryshimin dhe plotësimin e kësaj Rregullore i paraqiti Drejtori e gjithashtu edhe ju i keni marr me shkrim, andaj hapi shqyrtimin.

Blerim Gashi, unë propozoj që në neni 14 pika 1.4 të thuhet për student për kuadrat deficitare.

Vlora Limani-Hajnuni, unë disa herë kam kërkuar në këtë Kuvend që t'i përmbaheni Rregullores së punës së Kuvendit dhe gjithëqka do të jetë oke, andaj pyes Blerimin se a e ka dhënë me shkrim këtë propozim se unë ditën e fundit nuk mund t'i marr të gjitha propozimet për ndryshim.

Hajrije Salihu, Blerimi ka të drejtë se gjithësisht nuk është mirë kjo Rregullore.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj Rregullore Kryesuesja lexoi ndryshimet që duhet të bëhen në Rregullore e të cilat i paraqiti edhe Drejtori i Administratës dhe pastaj vuri në votim propozimin e Rregullores së bashku me ndryshimet për plotësim dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 15 vota për, 12 kundër dhe asnjë apstenim aprovoi këtë:

Rregullore **Për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve**

Shtesë: Rregullorja dhe propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores.

III

Propozim Vendim për emërtimin e parkut të qytetit me emrin e Heroit të Kosovës "Ismet Asllani"

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Avni Olluri, Drejtor i DGJK, i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës dhe të pranishmit të tjerë e veqanërisht familjarët prezent të Heroit Ismet Asllani. Pastaj lexoi fjalën e përgatitur me shkrim lidhur me biografin e Heroit Ismet Asllani si dhe aktivitetet dhe kontributin e tij si para lufte ashtu edhe gjatë luftës deri në ditën e rënies me 24 mars të vitit 1999.

Hajrije Salihu, është nder i madh kur flitet për dëshmorët dhe heronjë të pavarësisht nga kush ka ardhur ideja dhe propozimi për emërtimin e parkut të qytetit me emrin e Heroit të Ismet Asllani unë e përkrahu dhe dëshiroj që Lipjani ta gëzojë këtë.

Florent Hoxha, fillimisht përshëndeti familjen Asllani duke falenderuar për kontributin që kanë dhënë para lufte dhe pas luftës për lirinë e Kosovës. Pastaj tha se në KPF e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim për emërtimin e parkut të qytetit të Lipjanit me emrin e Heroit të Kosovës Ismet Asllani dhe ne e mbështesim këtë propozim. Në vazhdim tha se është mirë që edhe në të ardhmen rrugët, sheshet, parqet etj. të emërtohen me emrat e Heronjëve dhe Dëshmorët e Kosovës.

Ramiz Qeriqi, falenderoj familjen e Ismet Asllanit dhe ne e përkrahim këtë propozim Vendim dhe unë personalisht kam propozim që për një ditë të zbulohen edhe busti i Adem Jasharit edhe i Ismet Asllanit.

Arben Bahtiri, është propozim me vend nga zyra e Kryetarit dhe kjo është familje emblematike për Komunën e Lipjanit dhe komunat tjera dhe vepra e tij flet shumë, andaj kërkoj që në mënyrë institucionale t'i ndihmohet kësaj familje dhe familjeve tjera si kjo.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, fillimisht përshëndeti Milim Asllanin vëllau i Heroit Ismet Asllani dhe familjarët tjerë prezent të Heroit Ismet Asllani. Pastaj tha se ndihemi mirë dhe i nderuar që tani së bashku kemi marrë këtë hap dhe unë do të mbetem i përkushtuar që në vitin 2017 të sigurojmë mjetet financiare për ndërtimin e një lapidari të përmasave të trupit real që ka pasë edhe të Ismetit edhe të Adem Jasharit me shëndet e bajtë këtë emër Milaim, familja e juaj.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, miratoi këtë:

VENDIM

PËR EMËRTIMIN E PARKUT TË QYTETIT ME EMRIN E HEROIT TË KOSOVËS ISMET ASLLANI

Neni 1

Me këtë Vendim **emërtohet** zona e qarkullimit publik, përkatësisht parku i qytetit me emrin e heroit të Kosovës Ismet Asllani që evidentohet në njësinë kadastrale nr P-71409044-01796-2, në vendin e quajtur Varosh ZK Lipjan në sipërfaqe prej 2385 m² ,pronë shoqërore e shkollës fillore, pranë objektit të shkollës fillore "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit , Drejtorati për Gjeodezi , Kadastër dhe Pronë dhe Drejtorati për Shërbime Publike.

Neni 3

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të pushtetit lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi

Pas përfundimit të kësaj pike Kryesuesja në ora 12,⁰⁵ dha pauzë deri në ora 13,⁰⁵.
Pas pauzës në ora 13,⁴⁰ Kuvendi vazhdoi punës sipas pikës së katërt.

IV

Propozim Vendim për miratimin e planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Fauz Xhemajli, drejtor i DA, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi dhe nga plani me plotësim që aty ku është fjala konflikt të thuhet luftë .

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Burbuqe Fazliu, ne si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë plan dhe të njëjtin e përkrahu.

Ramiz Qeriqi, ky material më ka ardhur edhe në gjuhën serbe dhe nuk e di se të tjerëve a u ka shku kështu apo vetëm ndaj meje është bërë provokim.

Enver Kozhani, na si grup parlamentar e përkrahim këtë plan por kërkoj që ky plan të mos keqpërdoret siqë është keqpërdorë në Babush ku për të kthyerit janë ndërtuar shtëpit dhe asnjë familje nuk është kthyer e gjithashtu ka familje që është kthyer dhe i është ndërtuar shtëpia e më vonë e ka shitur shtëpin. Në fund pyeti se sa do të kushtoj kthimi i këtyre 11 familjeve.

Vlora Limani-Hajnuni, në faqën 5 të planit thuhet para konfliktit të vitit 1999 dhe pajtohem që në vend të fjalës konflikt të thuhet para luftës të vitit 1999 se nuk ka qenë konflikt por luftë.

Florent Hoxha, edhe UNHCR edhe organizata tjera ndërkombëtare e quajnë konflikt dhe realisht nuk ka qenë konflikt por ka qenë lufta e UÇK-së dhe na me votën tonë mos ta bëjmë konflikt por të thuhet luftë se ka qenë luftë.

Adelina Krasniqi, me këtë plan mendoj se do të bëhet zgjidhje për të zhvendosurit dhe na si të tillë e përkrahim këtë plan.

Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës, këtë plan e ka hartuar UNHCR dhe në të gjitha shtetet e ish Jugosllavisë i ka quajtur konflikt por na mund të themi luftë në vend të fjalës konflikt.

Pastaj tha se Enveri e përmendi Babushin që e kanë keqpërdor por na kemi edhe në Komunën tonë që ka pasur keqpërdorime.

Sa i përket financimit nga Komuna ne i kemi parapa mjetet me buxhet dhe këto mjete janë të parapara vetëm për mbajtje të takimeve.

Sa i përket kërkesave për kthim janë pranuar vetëm 11 raste a ka pasur më shumë kërkesa dhe Komuna shumë pak shpenzime ka me këtë plan dhe atë përmes ZLK-së për takimet që do të organizohen me donatorë.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja vuri në votim propozim evendimin së bashku me planin me propozimin që te fjala konflikt të thuhet luftë dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, miratoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR TË ZHVENDOSURIT DHE
ZGJIDHJE TË QËNDRUESHME

Neni 1

MIRATOHET , Plani komunal i veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani komunal i veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Zyra Lokale për Komunitete.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës .

Shtesë: Vendimi.

V

Raport nga DKRS për aktivitetet sportive

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Basri Hashani, drejtorit të DKRS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Nehat Tërpeza, falenderoj Drejtorin për paraqitjen e këtij raporti dhe si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë raport ku sipas tij shihet se ka arritje të duhura si në investime kapitale siqë është ndërtimi i qendrës sportive në Magurë dhe në fushat tjera si të kulturës, rinisë dhe sportit e gjithashtu edhe në përfshirjen e datave të rëndësishme për aktivitetet e ndryshme, andaj ne si grup parlamentar e përkrahim këtë raport.

Hajrije Salihu, në rend ditës është thënë informatë a materiali është raport dhe ka shumë gabime gjuhësore.

Ali Stublla, unë po ndalem te ana financiare përkatësisht te subvencionet dhe po më intereson te klubi “Ulpiana” ku Komuna ka ndarë 25 mijë euro për këtë klub dhe e përmendi Luani se ndeshja nuk është luajt si vendas dhe nuk e dijë se Drejtori a është marr me këtë qështje.

Te klubi “Arbëria” në Dobrajë nuk po e shoh se është financu por shkolla e futbollit në Dobrajë është financu me 4 mijë euro.

Florent Hoxha, sipas planit të punës së Kuvendit është dashtë të paraqitet informatë mirëpo Drejtori e ka paraqit raport dhe sipas mendimit tim raporti duhet të jetë më i detajuar se sa ky.

Në raport janë paraqitur aktivitetet dhe fare nuk janë paraqitur sfidat me të cilat është ballafaqu Drejtoria dhe në bazë të sfidave dhe vështërsive mund të ipen edhe rekomandimet.

Për 28 nëntor nuk është organizu akademi solemne e që sipas mendimit tim është dashtë të mbahët akademia solemne. Në vazhdim tha se janë paraqitur aktivitetet dhe ato aktivitete janë marrë kopi-past ashtu siqë kanë qenë të organizuara më herët a dihet se tani kanë ndodh ndryshime.

Pastaj pyeti se gjatë këtij viti kalendarik a është dorëzu ndonjë raport lidhur me subvencionet që u janë dhënë OJQ-ve etj.

Në Lipjan ekziston ansambli “Ulpiana” por po më intereson se a ka ansambël tjetër?

Blerim Gashi, dëgjuam Drejtorin për raportin dhe shumica e aktiviteteve që janë bërë janë të përsëritshme që këtë e ceku edhe Florenti. Gjendja e kulturës në Lipjan është në gjendje të mjerueshme dhe na duhet me e ndërru qasjen për ta ndryshu këtë gjendje që e kemi. Mirëpo për ta ndryshuar këtë duhet të shtohet edhe buxheti. Për të gjitha aktivitetet në ftesa thuhet nën patronatin e Kryetarit dhe Drejtoria po mbetet askund. Gjithashtu tha se me kalendarin e festave 28 nëntori nuk është festë a realisht duhet të jetë festë.

Nazmi Krasniqi, 28 nëntori dita e Flamurit në Lipjan ka dështu kësaj here. Në vazhdim pyeti se si qëndron qështja e shtëpisë së kulturës “Tahir Sinani” në Lipjan.

Lulzim Rustemi, Drejtori e tha se në kuadër të Drejtoratit janë 15 punëtorë dhe unë mendoj që brenda këtij drejtorati duhet të angazhohen ata punëtorë dhe të organizohet një punë e veçant për organizimin e manifestimeve të ndryshme se datat e festave nuk ndryshojnë dhe duhet të ofrojmë një qasje tjetër për t'i shtyrë qytetarët për përcjelljen e këtyre datave dhe të prezantojmë në aktivitetet që organizohen. Në vazhdim tha se drejtorati e din që ka dështuar edhe në organizimin e turnireve të futbollit dhe akademitë që kemi pasur. Në vazhdim pyeti Drejtorin se a ka të planifikuar mirëmbajtjen e lapidarëve, të Dëshmorëve dhe Martirëve dhe komplekset memoriale.

Arben Bahtiri, na e dijmë se për DKRS-në mjetet janë të kufizuara por edhe unë pajtohem se duhet të jetë një qasje më ndryshe për organizimin e aktiviteteve kulturore.

Për ditët e diasporës është mirë të mbahen takime dhe aktivitete më të shpeshta.

Për klubet sportive duhet të ndahen më shumë mjete por nga ata duhet të kërkohët edhe raporti i shpenzimeve.

Basri Hashani, unë i kërkoj falje profesoreshës për gabimet gjuhësore në raport.

Sa i përket klubit futbollistik “Arbëria” në Dobrajë ne e dijmë se aty është formuar edhe shkolla e futbollit por na mjetet i kemi qitë në xhirollogarin e klubit “Arbëria”.

Sa i përket festës së 28 nëntorit Ditës së Flamurit mbledhje solemne kemi mbajtur vetëm për 100 vjetorin kurse viteve tjera nuk kemi mbajtur mbledhje solemne.

Sa i përket ndarjes së mjeteve nga buxheti, na kemi ndarë mjete për 8 klube sportive dhe për 2 individ dhe këto mjete janë aprovu nga Kuvendi.

Për 28 nëntor kemi parapa turnir dhe janë paraqitë 7 ekipe por ditën e fundit nuk kanë ardhur ekipet dhe ky turnir ka dështu.

Blerim Gashi, unë nuk e kam njohurin se klubi ka marrë subvencione nga Kuvendi dhe nuk e ka zhvilluar ndeshjen si vendas dhe nëse janë përdorë këto mjete atëherë vitin e ardhshëm mos të ju ndajmë mjete.

Vlora Limani-Hajnuni, me Rregulloren për subvencione është parapa se nëse një organ apo klub i keqpërdorin mjetet nuk kanë të drejtë 3 vite të marrin subvencione e gjithashtu një pjesë të mjeteve duhet t`a kthejnë.

Basri Hashani, ne për klubin futbollistik “Ulpiana” kemi ndarë 20 mijë euro dhe unë nuk kam informatë për mos zhvillimin e ndeshjes.

Sa i përket raportit të shpenzimeve të gjitha klubet dhe OJQ-të e kanë paraqitë raportin e shpenzimeve.

Pasi qështje tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 14,⁴⁵

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni